



Kthim përgjigje_Pespa Alumin

From

Date Tue 20/01/2026 13:36

To

Përshëndetje,

Përgjigje e mëposhtme duhet ta dërgojmë ndaj subjektit
15.01.2026.

shpk, dërguar e-mail më datë

Në përgjigje të e-mail-it tuaj, më datë 15.01.2026 "Kërkesë për informacion", protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme e Metrologjisë me nr. 126 prot., datë 16.01.2026, Ju bëjmë me dije si më poshtë.

1. Referuar ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për instrumentin matës, peshore, kryen shërbimin e verifikimit dhe kalibrimit të tyre (deri në kapacitetin 100 kg).
Për të kryer shërbimin e verifikimit ose kalibrimit duhet të drejtoni kërkesë zyrtare, duke specifikuar karakteristikat (të dhënat) e peshores/eve, shërbimin që dëshironi të kryeni (verifikimin ose kalibrimin), emrin dhe adresën e subjektit ku ndodhen/përdoren peshoret, si dhe të dhëna të kontaktit të subjektit.
Kërkesa mund të dërgohet përmes adresës elektronike të e-mailit të DPM, në rrugë postare, ose dorazi në protokollin e DPM-së.
2. Për realizimin e shërbimit të verifikimit/kalibrimit të peshoreve nuk kërkohet/nevojitet dorëzim dokumentacion prej subjektit.
3. Shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara është detyrim ligjor dhe periodiciteti (afati/interali i detyrueshëm i verifikimit periodik) është çdo 12 muaj, i përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të MFE nr. 219, datë 21.09.2022 "Për miratimin e rregullores së verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar"; Shërbimi i kalibrimit të instrumenteve matëse është fakultativ dhe nuk ka interval/afat shërbimi.
4. Tarifat e shërbimeve janë të përcaktuara në Udhëzimin e Përbashkët nr. 2, datë 08.02.2013 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) "Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë" dhe tarifa ndryshon referuar specifikave të peshores. Shërbimi i verifikimit dhe kalibrimit nuk ka kosto shtesë dhe mënyra e pagesës së tarifës është parapagim.
5. Referuar legjisllacionit për metrologjinë nuk përcaktohen detyrime të tjera procedurale për subjektet, që kërkon shërbim nga DPM, ndërsa detyrimet e përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim, janë të përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë".

Duke ju falenderuar,